

## SHOQERIA "ILIRIA '98" Sh.p.k

### Shënime Shpjeguese

të

### Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

#### Informacion i përgjithshëm

Shoqeria "ILIRIA '98" Sh.p.k është themeluar si Shoqeri me Përgjegjesi të Kufizuar, me Objekt kryesor të Veprimtarisë "Këmbim Valutor", me Licence Nr. Nr. 12, datë 25.02.2000, leshuar nga Banka e Shqipërisë.

Shoqëria është regjistruar si një person juridik sipas vendimit të Gjykatës datë 19019, DATE 12/03/1998, me numër NIPT-i K11329003H dhe vepron në përputhje me Ligjin "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe ligjeve të tjera që rregullojnë biznesin në Shqipëri.

Me zyra qendrore ngjitur me Teatrin e Kukullave, Tirane, Shqipëri.

Tre aksionerët e Shoqërisë janë z. Ali Topalli me 33.33 %, z. Ilir Janku me 33.33 % dhe z. Edmond Ymeri me 33.34 % të kuotave të Shoqërisë.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë për ushtrimin 2021 është "Këmbimi Valuator".

#### Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

##### Deklarata e përputhshmërisë

Politikat kryesore të kontabilitetit të adaptuara në përgatitjen e pasqyrave financiare, janë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

##### Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në parimin e kostos historike.

##### Monedha funksionale dhe raportuese

Monedha e raportimit është Leku Shqiptar ("Lek") që është gjithashtu edhe monedha funksionale.

##### Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen. *Shoqëria nuk ka gjykuar për çmuarje kontabël që të pasqyrohen në PF të Shoqërisë.*

##### Konsequenca e politikave kontabile

Politikat kontabël më poshtë janë aplikuar në mënyrë konsistente në këto pasqyra financiare në të gjitha periudhat e paraqitura.

##### Aktivet Afat Gjate dhe Afat Shkurter

##### Aktivet Afatgjata Materiale – AAM-te

##### Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale (AAM) paraqiten me kosto minus amortizimin.

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivitetit.



Kosto e aktiveve të ndërtuara vetë përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivitetit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësinë e dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimi ose humbja që vjen nga pakësimi i një zëri të aktiveve afatgjata materiale përcaktohet duke krahasuar shumën e arkëtuar nga pakësimi me vlerën kontabël të zërit, dhe njihet në baza neto në të ardhurat/shpenzimet e tjera operative në fitim ose humbje.

### Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundur që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Shoqëri, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në fitim ose humbje në momentin kur ndodhin.

### Amortizimi

Amortizimi njihet në fitim ose humbje si më poshtë:

<u>Kategoria</u>	<u>Metoda</u>	<u>Norma e Amort.</u>
Ndërtesa dhe instalime	Mbi vlerën e mbetur	5%
Pajisje Zyre Informatike dhe Televizive	Mbi vlerën e mbetur	25%
Mjete transporti	Mbi vlerën e mbetur	20%
Mjete transporti me qera financiare	Mbi vlerën e mbetur	20%
Mobilje dhe pajisje zyre	Mbi vlerën e mbetur	20%

*Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohet në çdo datë raportimi dhe paraqitet si më poshtë;*

### Aktivet afatgjata materiale më 31 dhjetor 2021:

EMERTIMI	Ndertesat dhe Instalime	Pajisje Informatike dhe Televizive	Automjete	Mobilje dhe Pajisje Zyre	TOTALI
VI.Fillestare(Kosto) 01 Janar 2021	15.875.000	10.946.871	2.139.500	6.842.999	35.804.370
Shtesa	0	1.299.763	0	682.366	1.982.129
Paksime	0	0	0	0	0
<b>Gj.31.Dhjetor 2021</b>	<b>15.875.000</b>	<b>12.246.634</b>	<b>2.139.500</b>	<b>7.525.365</b>	<b>37.786.499</b>
Amortizimi Akumuluar	1.995.537	9.011.592	1.936.968	5.338.327	18.282.424
Amortizimi i Vitit 2021	693.973	565.525	88.557	340.539	1.688.594
Paksime	0	0	0	0	0
<b>Gj.31.Dhjetor 2021</b>	<b>2.689.510</b>	<b>9.577.117</b>	<b>2.025.525</b>	<b>5.678.866</b>	<b>19.971.018</b>
VI.Kontabel 31.12.2021	<b>13.185.490</b>	<b>2.669.517</b>	<b>113.975</b>	<b>1.846.499</b>	<b>17.815.481</b>



### Aktivet me qera

Qeratë, në kushtet e të cilave Shoqëria merr në thelb të gjitha risqet dhe shpërblimet e pronësisë, janë të klasifikuara si qera financiare. Në momentin e njohjes fillestare, aktivi me qera, matet me një shumë të barabartë me vlerën më të vogël midis vlerës së drejtë dhe vlerës aktuale të pagesave minimale të qerasë. Pas njohjes fillestare, aktivi kontabilizohet në përputhje me politikën kontabël të zbatueshme për atë aktiv.

*Ky interpretim nuk ka ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë.*

*Qeratë e tjera janë qera operative dhe nuk njihen në pasqyrën e pozicionit financiar të Shoqërisë.*

### Aktivet Aafat Shkurtra

#### Inventarët

Inventarët janë vlerësuar me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto e inventarëve llogaritet bazuar në parimin e kostos mesatare të ponderuar dhe përfshin koston e blerjes, kostot e shndërrimit dhe gjithë kostot e tjera për të sjellë inventarët në vendodhjen dhe në kushtet aktuale. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes përgjatë aktivitetit normal të Shoqërisë, minus kostot e vlerësuara të përfundimit e shitjes.

*Ky interpretim nuk ka ndikim në pasqyrat financiare, mbasi për llojin e aktivitetit që ushtron shoqëria nuk administrohet Inventar Material.*

#### Instrumentat financiarë

Shoqëria zotëron vetëm instrumenta financiarë jo-derivativë të përberë nga mjete monetare dhe ekuivalente me to, klientë dhe të tjera llogari të arkëtueshme, furnitorë dhe të tjera llogari të pagueshme dhe huamarrje.

Shoqëria fillimisht njih të arkëtueshmet dhe depozitat në datën e krijimit. Aktivet financiare regjistrohen nëse të drejtat kontraktuale të Shoqërisë ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivi financiar mbarojnë, ose nëse ajo i transferon të drejtat për të arkëtuar flukse nga aktivi financiar një pale tjetër, duke transferuar të gjitha risqet dhe përfitimet që lidhen me aktivin. Çdo interes në aktivet financiare të transferuara që përfitohet ose mbahet nga Shoqëria njihet si një aktiv ose detyrim më vete.

Aktivët dhe detyrimet financiare prezantohen neto në pasqyrën e pozicionit financiar, vetëm në rast se Shoqëria ka të drejtën ligjore dhe qëllimin për të shlyer ose arkëtuar njëherësh detyrimin ose të drejtën neto.

#### Klientë e llogari të tjera të arkëtueshme

Të arkëtueshmet janë aktive financiare me pagesa fikse ose të përcaktueshme, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive. Këto aktive njihen fillimisht me vlerë të drejtë plus kosto direkte të transaksionit. Në vazhdim, të arkëtueshmet maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe duke zbritur humbjet kumulative nga zhvlerësimi.

*Ky interpretim nuk ka ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë mbasi;*

- *Shoqëria nuk ka gjendje “kliente”, veprimet janë ditore dhe kryesisht në cash.*
- *“Llogaria të tjera të arkëtueshme”, perbehet nga paradheniet e dhena nga shoqëria për qiramarrjet e objekteve, ku zhvillohet aktiviteti i Zyrave të Kembimit Valutor dhe,*
- *“Aktive të tjera financiare” që perfaqson një kredi të marre nga Aksionerët e Shoqërisë në perdorim personal, plotësisht të arkëtueshme dhe pa efekte në aktivitetin e shoqërisë.*

*Te cilet me 31.12.2021 paraqiten si me poshte;*



Ne Leke

EMERTIMI	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
<b>Llogari te tjera te Arketueshme</b>		
418-Parapagim Qiraje	1.109.192	1.109.192
486-Shpenzime te perudhave te ardhshme	2.200.000	3.400.000
455-Ortake(Kredi e marre per perdorim personal)	21.553.902	23.173.453
<b>Shuma</b>	<b>24.863.093</b>	<b>27.682.645</b>

**Mjete monetare dhe ekuivalente me to**

Mjete monetare dhe ekuivalente me to përfshinë paratë në arkë, në llogarite rrjedhëse në banka dhe në mjete monetare në tranzite që përfason një arketim ose veprim me bankën dhe të pa mbyllur brenda datës 31.12.2021.

Keto mjete monetare menaxhimi i shoqërisë i ka në dispozicion në çdo kohë dhe gjendja më 31.12.2021 paraqitet si më poshtë;

Ne Leke

EMERTIMI	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Mjete monetare dhe ekuivalente me to :		
Vlera Monetare - Në Arke	53.024.212	33.389.200
“ “ - Në Banke	142.719.134	204.049.817
Aktive të tjera – Mjete monetare në tranzit	85.200.000	0
<b>Shuma</b>	<b>280.943.346</b>	<b>237.439.017</b>

**Detyrimet dhe Kapitali**

**Kapitali aksioner dhe Rezervat**

Kapitali aksioner i Shoqërisë është i njohur me vlerën nominale.

Politika e Shoqërisë është të mbajë një bazë të fortë kapitali në mënyrë që të ruajë besueshmërinë e investitorëve dhe kreditorëve dhe të mbështesë zhvillimin e mëtejshëm të biznesit.

Shoqëria nuk është subjekt i kërkesave të kapitalit të vendosura nga ente rregullatore.

Vlera e kapitalit aksionar të autorizuar, rregjistruar dhe paguar i Shoqërisë më 31 Dhjetor 2021 dhe 2020 paraqitete si më poshtë:

Ne Leke

EMER MBIEMER	Numur Kotash	31 Dhjetor 2021 ne %	Ne leke	Numur Kotash	31 Dhjetor 2020 ne %	Ne leke
Kapitali Aksioner						
Ali Topalli	1	33.33	73.333.333	1	33.33	61.666.666
Ilir Janku	1	33.33	73.333.333	1	33.33	61.666.667
Edmond Ymeri	1	33.34	73.333.334	1	33.34	61666.667
<b>Shuma</b>	<b>3</b>	<b>100.00</b>	<b>220.000.000</b>	<b>3</b>	<b>100.00</b>	<b>185.000.000</b>
Rezerva Ligjore			24.005.045			21.200.000
<b>Totali</b>			<b>244.005.045</b>			<b>206.200.000</b>



Burimi i ketij Kapitali dhe i Rezerves ligjore eshte nga fitimi. Kjo rritje ka ardhur nga nevoja qe ka Menaxhimi i Larte i Shoqerise per zhvillimin dhe rritjen e ketij biznesi

### Detyrime financiare Afat Gjate

Detyrime financiare përfshijnë huamarrjet dhe llogari të tjera të pagueshme.

Shoqëria fillimisht njeh llogaritë e pagueshme në datën kur ato janë krijuar. Detyrimet financiare regjistohen nëse detyrimet e Shoqërisë të detajuara në kontratë përfundojnë, janë shlyer ose janë anuluar. Këto detyrime financiare njihen fillimisht me vlerë të drejtë plus koston direkte të transaksionit. Në vazhdim, këto detyrime financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

*Ky interpretim nuk ka ndikim në pasqyrat financiare të Shoqerise, mbasi ne kete kapitull perfshihet vetem nje Huamarrje nga Aksioneret e shoqerise per nevoja personale si me poshte;*

Ne Leke		
E M E R T I M I	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Huamarrje-Ortakët për nevoja personale	21.553.902	23.173.453
Shuma	<b>21.553.902</b>	<b>23.173.453</b>

### Detyrime financiare Afat Shkurter

Ne leke

Llog.	E M E R T I M I	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
467	Qiraja – Dhjetor 21 Airporti Rinas	1.165.735	0
431	Sig.Shoq – nga viti 2020	24.563	24.563
431	Sig.Shoq-Dhjetor 2021	689.306	549.213
442	Tatim mbi te ardhurat personale – Dhjetor 21	177.734	142.983
449	Tatim ne Burim – Dhjetor 21	181.440	171.810
444	Tatim fitimi per tu paguar – Bilanci 20221	1.535.861	-3.604
	<b>Shuma</b>	<b>3.774.639</b>	<b>887.965</b>

Detyrime qe rrjedhin nga aktiviteti normal i biznesit dhe qe perfshijne detyrime te muajit Dhjetor 2021 plotsisht te paguashme ne perputhje me afatet ligjore fiskale ne janar 2022.

### Zhvlerësimi

#### Aktive financiare

Një aktiv financiar, i cili nuk regjistrohët me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, vlerësohet në fund të çdo periudhe raportuese për të përcaktuar nëse ka evidencë objektive që tregon se mund të jetë i zhvlerësuar. Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse evidenca objektive e zhvlerësimit tregon se një ose më tepër ngjarje që kanë ndodhur kanë patur një ndikim negativ në flukset e çmuara të ardhshme të mjeteve monetare të aktivitetit financiar dhe kjo mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Evidenca objektive që aktivitetet financiare të zhvlerësohen mund të përfshijë mospagimin nga huamarrësi, ristrukturimin e e shumës që i detyrohet Shoqërisë me kusht që Shoqëria nuk do t'i kishte konsideruar në një rast tjetër, të dhëna që një huamarrës do të falimentojë, ndryshime negative në statusin e pagesave të huamarrësit ndaj Shoqërisë, kushte ekonomike që lidhen me dështimin e pagesave ndaj Shoqërisë ose zhdukja e një tregu aktiv për letrat me vlerë.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare skontuar me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit financiar.

Aktivet financiare të cilat janë të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në baza individuale. Pjesa e mbetur e aktiveve financiare vlerësohet bashkarisht në grupe që mbartin karakteristika të ngjashme risku. Për trajtimin e zhvlerësimit kolektiv Shoqëria përdor trendet historike të probabilitetit të mospagimit, kohës së rikuperimit dhe vlerën e humbjes së ndodhur, përshtatur me gjykimin e drejtimit nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kreditit janë të tilla që humbjet aktuale të jenë më të mëdha ose më të vogla se ato të përcaktuara nga modelimet historike.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Një humbje zhvlerësimi mund të anulohet nëse ulja në zhvlerësim ka ndodhur për shkak të një ngjarjeje që ka ndodhur pasi është njohur zhvlerësimi. Anullimi njihet në fitim ose humbje.

#### Aktive jo-financiare

Vlera e mbartur e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarëve dhe aktiveve tatimore të shtyra, është rishikuar në fund të çdo periudhe raportuese për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim. Nëse ekzistojnë tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbartur e aktivitetit ose e njësisë gjeneruese të aktiveve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje.

Një njësi gjeneruese e parasë është grupi më i vogël i identifikueshëm që gjeneron fluxe monetare gjerësisht të pavarura nga grupet apo aktivitetet e tjera. Vlera e rikuperueshme e një aktivi apo e një njësie gjeneruese të parasë është me e madhja ndërmjet vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë të tij pasi janë zbritur shpenzimet e shitjes.

Përsa i përket aktiveve të tjera, një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse ka tregues që kjo humbje nuk ekziston më dhe ka pasur ndryshime në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën në përdorim. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret deri në atë masë sa vlera e mbartur e aktivitetit nuk tejkalon vlerën e mbartur që do të ishte përcaktuar si vlerë neto pas zbritjes së amortizimit dhe nëse nuk do të ishte njohur humbje nga zhvlerësimi.

#### Të ardhura nga aktiviteti kryesor

##### Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shitja gjatë rrjedhës së aktivitetit normal të biznesit maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose që është për t'u marrë, përjashtuar skontot tregtare dhe taksat mbi shitjet. Të ardhurat njihen kur rreziqet dhe përfitimet domethënëse të pronësisë i janë transferuar blerësit, është e mundur marrja e shumës së konsideruar, kostot shoqëruese dhe kthimet e mundshme të të mirave janë të vlerësueshme në mënyrë të besueshme, nuk ka përfshirje të vazhdueshme të manaxhimit me mallrat, dhe shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme.

E ardhura nga shërbimet e kryera njihet në fitim ose humbje në proporcion me fazën e realizimit të transaksionit në datën e raportimit.

#### **Të ardhura nga aktiviteti kryesor "Kembim Valutor" me 31.12.2021 paraqiten si me poshte;**

Ne leke

EMERTIMI	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Te Ardhura nga Aktiviteti kryesor	139.581.084	118,570,994
Te Ardhura te Tjera	0	0
<b>Shuma</b>	<b>139.581.084</b>	<b>118.570.994</b>





Te ardhurat jane rritur rreth 18 %, ne krahasim me vitin 2020 e cila ka ardhur nga dalja, megjithse me ritme te ngadalta e ekonomise ne pergjithsi nga ndikimi i pandemise, por edhe nga nje rritje edhe me tre Zyra te reja te Kembimit Valutor gjate vitit 2021 ne disa zona te tjera te Tiranes.

### Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat nga fondet në banka. E ardhura nga interesi njihet kur ai përfitohet, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijne shpenzimet e interesit për huamarrjet.

Kostot e huasë qe nuk lidhen direkt me blerjen, ndërtimin apo prodhimin e një aktivi që kualifikohet për kapitalizimin e këtyre kostove, njihen direkt ne rezultat duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Fitimi dhe humbja nga kursi i këmbimit prezantohen neto si e ardhur ose shpenzim financiar në varësi nëse lëvizjet në kursin e këmbimit janë në një ekspozim neto fitimi apo humbje.

### **Te ardhurat dhe Shpenzimet financiare neto me 31.12.2021 paraqiten si me poshte;**

Ne Leke		
E M E R T I M I	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Te Ardhura nga interesat neto	1.834	1.960
Te ardhurat nga ndryshimi i kursit te kembimit	149.431	1.507.499
<b>Shuma</b>	<b>151.265</b>	<b>1.509.459</b>

### Shpenzimet e Aktivitetit

#### Shpenzime Energji dhe Uje

Ne Leke		
E M E R T I M I	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Uje dhe Energji (Ilog 605 dhe 608)	3.666.199	3.168.380
<b>Shuma</b>	<b>3.666.199</b>	<b>3.168.380</b>

Jane dy zera te shenzimeve, Energji dhe Uje, rritja ne krahasim me vitin 2020 vjen nga rritja e cmimeve e ketyre dy produkteve dhe te taksave te perkohshme te perfshira ne keto dy zera dhe nga shtimi i numurit te Zyrave te Kembimit.

### Shpenzime personeli

Ne leke		
E M E R T I M I	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Paga Personeli	29.587.317	24.518.698
Sigurime shoqërore	4.571.101	3.631.933
<b>Shuma</b>	<b>34.158.418</b>	<b>28.150.631</b>

Keto dy zera, Paga dhe Sigurime jane rritur nga njeri vit ne tjetrin dhe ne krahasim me vitin 2020 jane rritur rreth 21 %, kjo ka ardhur, krahas rritjes se numurit te Zyrave e cila eshte shoqeruar edhe me rritjen e personelit ku nga 42 qe ka qene numuri i punonjesve ne 01 Janar 2021 ne fund te viti ka shkuar ne 47, por edhe nga rishikimi i vazhdueshem qe Drejtimi i Shoqerise i ka bere nivelit te pagave per punonjesit.

## Përfitimet e punonjësve

### *Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore*

Shoqëria paguan vetëm kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme që përcaktojnë përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Qeveria Shqiptare është përgjegjëse për përcaktimin e limitit ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri. Kontributet e Shoqërisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen kur ato ndodhin.

### *Pagesa për lejet vjetore*

Shoqëria njih si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të vlerësuara në lidhje me lejet vjetore që pritet të paguhet në këmbim për shërbimin e punonjësve gjatë periudhës.

## Shpenzime të tjera operative

Ne Leke

Llog	E M E R T I M I	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
613	Qira	21.329.797	15.432.452
615	Mirembajtje dhe riparime	184.300	24.162
621	Personel jashte njesise	307.000	236.000
625	Transferime, udhetim, dieta etj	50.000	0
626	Shpz.postare e telekom:	2.879.501	3.004.516
628	Shpenz. sherbime bankare(komisione)	8.004.603	6.960.460
634	Taksa dhe Tarifa Vendore	2.484.348	2.119.161
638	Tatime te tjera(Tat.ne Burim-Shoqeria)	930.420	727.570
657	Gjoha dhe demshperblime	10.000	16.110
681	Amortizimet e aktiveve afatgjata	1.688.594	1.515.603
	<b>Shuma</b>	<b>37.868.563</b>	<b>30.036.034</b>
694	Tatimi mbi fitimin - i Bilancit	9.754.438	6.246.668
	<b>Shuma</b>	<b>47.623.001</b>	<b>36.282.702</b>

## Pagesat e qerasë

Pagesat e bëra për qeranë operative njihen në fitim ose humbje në mënyrë lineare përgjatë periudhës së qerasë. Stimujt e marrë për qeranë njihen si pjesë integrale e pagesës totale të qerasë përgjatë kohëzgjatjes së qerasë.

Pagesat minimale të qerasë të bëra nën kontratat e qerasë financiare ndahen në mes të shpenzimeve financiare dhe pakësimit të detyrimit të mbetur. Shpenzimi financiar shpërdahet për cdo periudhë gjatë afatit të qerasë në mënyrë që të prodhojnë një normë konstante periodike interesi mbi tepricën e mbetur të detyrimit.

Pagesat e pritshme të qerasë regjistrohen duke riparë pagesat minimale të qerasë gjatë periudhës së mbetur të saj kur korrigjimi i qerasë konfirmohet.

## Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të shkuara, Shoqëria ka një detyrim ligjor ose konstruktiv i cili mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe ka shumë të ngjarë që për të shlyer detyrimin, të kërkohet një dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike. Provizionet janë përcaktuar duke skontuar flukset e pritshme monetare me një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe, sipas rastit, risqet specifike të



detyrimet. Amortizimi i skontos njihet si kosto financiare. Provizioni për garancitë njihet kur produkti ose shërbimi janë shitur. Provizioni bazohet në të dhënat historike për garancitë dhe ponderimit i të gjithë flukseve dalëse të mundshme me probabilitetet përkatëse.

### **Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit. Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetarë është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të konvertuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga konvertimi njihen në fitim ose humbje.

### **Tatim fitimi**

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i periudhës aktuale dhe ai i shtyrë njihen në fitim ose humbje përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose të ardhura të tjera përmbledhëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet ose të arkëtohet mbi fitimin apo humbjen e tatueshme të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi menjëherë në datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

### **Tatimi mbi Fitimin për vitin e mbyllur me 31.12.2021 dhe 31.12.2020 paraqitet si me poshte;**

Ne Leke

EMERTIMI	Norma e tatimit	31.12.2021	Norma e tatimit	31.12.2020
Fitimi para tatimit		64.039.169		58.725.408
Shpenzime të Panjohura		990.420		743.680
Shuma		65.029.589		59.469.088
Tatim Fitimi	15%	9.754.438	15%	8.920.363
Fitim/Humbja e Periudhes		54.284.731		49.805.045

*Më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 nuk ka patur diferenca të përkohshme ndërmjet vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të raportuara për qëllime tatimore. Rrjedhimisht, nuk është njohur aktiv ose detyrim tatimor i shtyrë në pasqyrat financiare të Shoqërisë.*

Tatimi i shtyrë është njohur për diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe bazës tatimore. Tatimi i shtyrë është matur duke përdorur normën tatimore që pritet të aplikohet ndaj diferencave të përkohshme kur ato kthehen, bazuar në ligjet në fuqi ose që hyjnë në fuqi në datën e raportimit.

Aktivitet dhe pasivet tatimore të shtyra netohen nëse ekziston një e drejtë ligjore për të netuar detyrimet për tatimin aktual të pagueshëm ndaj tatimit të parapaguar, dhe ato lidhen me tatimin mbi të ardhurat që përcakton i njëjti autoritet tatimor.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për humbjet fiskale të papërdorura, kreditime tatimore dhe diferenca të përkohshme të zbritshme për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit ato të mund të përdoren. Aktivitet tatimor i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet për aq sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal.

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe tatimit të shtyrë. Shoqëria merr në konsideratë ndikimin e një pozicioni tatimor të paqartë dhe tatimet dhe interesat shtesë që mund të lindin. Shoqëria beson se përlllogaritja e detyrimeve tatimore është e saktë për të gjitha periudhat e tatueshme bazuar në vlerësimin e disa faktorëve, duke përfshirë interpretimin e legjislacionit tatimor dhe ekperiencën e mëparshme. Kjo përlllogaritje mbështetet në vlerësime dhe supozime si dhe mund të përshijë një sërë gjykimesh rreth ngjarjeve të ardhshme.



*Në rast se si rrjedhojë e disponimit të një informacioni, gjykimi i Shoqërisë për mjaftueshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese ndryshon, ky ndryshim do të reflektohet në shpenzimin tatimor të periudhës kur ai përcaktohet.*

### **Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale**

Politikat kontabël të miratuara janë në përputhje me ato të vitit financiar të mëparshëm, përveç SNRF-ve të ndryshuara në vijim të cilat janë adoptuar nga Shoqëria më 1 janar 2019:

*Ndonëse këto standarde dhe amendamente të reja aplikoheshin për herë të parë në vitin 2018, ato nuk patën një ndikim material në pasqyrat financiare vjetore të Shoqërisë.*

*Natyrë dhe ndikimi i çdo standardi të ri ose amendimi përshkruhet më poshtë:*

#### **- SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët**

*Aplikimi i këtij standardi nuk ka ndikim në pasqyrat financiare të Kompanisë.*

#### **- SNRF 9 Instrumentet Financiare - Klasifikimi dhe matja**

Standardi prezanton kërkesat e reja për klasifikimin dhe matjen, zhvlerësimin dhe kontabilitetin mbrojtës.

*Zbatimi i këtij standardi nuk ka efekt material në pasqyrat financiare të Kompanisë.*

*Miratimi i SNRF 9 ka ndryshuar rrënjësisht kontabilitetin e Kompanisë për humbjet nga zhvlerësimi për aktivet financiare duke zëvendësuar metodën e humbjeve të ndodhura me SNK 39 me një qasje të pritshme të humbjes së kredisë (ECL).*

#### **- Transaksionet dhe Paradhënia në Monedhë të Huaj**

Sqarojmë se, në përcaktimin e kursit të këmbimit të castit për t'u përdorur në njohjen fillestare të aktivitetit, shpenzimeve ose të ardhurave (ose një pjese të tij) në c' regjistrimin e një aktivi jo-monetar ose detyrimi jo-monetar që lidhet me paradhënien, data e transaksionit është data në të cilën njësia ekonomike fillimisht njihet aktivin jo-monetar ose detyrimin jo-monetar që rrjedh nga parapagimi. Nëse ka disa pagesa ose arkëtime në avancë, atëherë njësia ekonomike duhet të përcaktojë datën e transaksionit për secilën pagesë ose arkëtim në avancë lidhur me paradhënien.

### **Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale**

*Ky interpretim nuk ka ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin financiar 2021.*

#### **Transferimet e Aktiveve afatgjata materiale të investuara**

*Aplikimi i këtij standardi nuk ka ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin financiar 2021.*

#### **Klasifikimi dhe matja e Transaksioneve të “Pagesave të bazuara në aksione”**

*Aplikimi i këtij standardi nuk ka ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin financiar 2021.*

#### **Instrumentet financiare. Kontratat e sigurimit**

*Këto ndryshime nuk janë të zbatueshme për Shoqërinë për vitin financiar 2021.*

#### **Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta**

*Ky standard nuk është i aplikueshëm për Shoqërinë për vitin financiar 2021.*

#### **Adoptimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar**

*Ky ndryshim nuk është i zbatueshëm për Shoqërinë për vitin financiar 2021.*

*Aplikimi i këtyre ndryshimeve në standardet ekzistuese dhe interpretimet nuk ka sjellë ndonjë ndryshim në politikat kontabël të Shoqërisë.*

#### **Standarte të emetuara por që ende nuk kanë hyrë në fuqi dhe nuk janë adoptuar**

*Kompania synon të miratojë këto standarde, nëse është e aplikueshme, kur ato të hyjnë në fuqi.*

#### **SNRF 16 – Qiratë**

*Shoqëria nuk synon të aplikojë këtë standart .*



## **SNRF 17 Kontratat e sigurimit**

*Shoqëria nuk synon të aplikojë këtë standart .*

## **Përmbledhje e politikave kontabël. Standarte te emetuara**

*Ky standard nuk është i aplikueshëm për Shoqërinë*

## **Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi te Ardhurat**

*Interpretimi trajton kontabilitetin për tatimin mbi të ardhurat kur trajtimet tatimore përfshijnë pasiguri dhe nuk përfshin në mënyrë specifike kërkesa lidhur me interesa dhe penalitete që lidhen me trajtimin e pasigurt tatimor.*

*Shoqëria nuk parashikon adoptimin e hershëm të interpretimit dhe aktualisht vlerëson ndikimin e saj.*

## **Karakteristikat e parapagimit me kompensime negative**

*Këto ndryshime nuk kanë ndikim në pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin 2021.*

## **Shitja ose Kontributi i Aktiveve midis një Investitori dhe Shoqatës së saj ose Sipërmarrjes së Përbashkët**

*Menaxhmenti ka vlerësuar se amendamenti i mësipërm nuk do të ketë ndikim mbi pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin financiar 2021.*

## **Standarte te emetuara por qe ende nuk kane hyre ne fuqi dhe nuk jane adoptuar (vazhdim)**

### **Ndryshimet në SNK 28: Interesat afatgjata në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta**

*Meqenëse Shoqëria nuk ka interesa të tillë afatgjatë në shoqërinë e saj dhe sipërmarrjen e përbashkët, ndryshimet nuk do të kenë ndikim në pasqyrat e saj financiare.*

### **SNRF 3 Kombinimet e Biznesit**

*Këto ndryshime do të zbatohen për kombinimet e ardhshme të biznesit të Shoqërisë.*

### **SNRF 11 Marrëveshjet e Përbashkëta**

*Këto ndryshime aktualisht nuk janë të zbatueshme për Shoqërinë, por mund të zbatohen për transaksionet e ardhshme.*

### **SNK 12 Tatimet mbi të Ardhurat**

*Këto ndryshime aktualisht nuk janë të zbatueshme për Shoqërinë, por mund të zbatohen për transaksionet e ardhshme.*

### **SNK 23 Kostot e Huamarrjes**

*Këto ndryshime aktualisht nuk janë të zbatueshme për Shoqërinë, por mund të zbatohen për transaksionet e ardhshme.*

### **Ligji i ri kontabël në Shqipëri**

*Ligji i ri 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i cili zëvendësoi ligjin e mëparshëm është përafëruar pjesërisht me Direktivën përkatëse të Bashkimit Evropian me qëllim të harmonizimit të plotë në vitin 2028.*

*Zbatimi i ligjit të ri kontabël nuk ka efekt mbi pozicionin financiar dhe performancën e Shoqërisë. Shoqëria ka zgjedhur të mos i miratojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave të tyre efektive.*

*Shoqëria parashikon që miratimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike në periudhën e aplikimit fillestar.*

## Përcaktimi i vlerës së drejtë

Disa politika kontabël dhe shënime shpjeguese kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë për aktivet dhe detyrimet si financiare ashtu edhe jo-financiare. Vlerat e drejta janë përcaktuar për qëllime matje dhe/apo shpjeguese bazuar në metodat e mëposhtme. Aty ku është e aplikueshme, informacion i mëtejshëm rreth supozimeve të bëra në përcaktimin e vlerës së drejtë është përfshirë në shënimet përkatëse të atij aktivi apo detyrimi.

### *Aktivitetet financiare të mbajtura me kosto të amortizuar*

Vlera e drejtë për llogaritë e arkëtueshme është vlerësuar me vlerën aktuale të flukseve të ardhshme monetare, skontuar me normën e tregut të interesit në datën e raportimit. Drejtimi ka njohur si vlerë të drejte koston historike për mungesë të tregut të vlerësimeve. Kjo vlerë e drejtë është përcaktuar për qëllime shënimi shpjegues.

### *Detyrimet financiare të mbajtura me kosto të amortizuar*

Vlera e drejtë, e cila është përcaktuar për qëllime shënimi shpjegues, është llogaritur bazuar në vlerën aktuale të flukseve të ardhshme të principalit dhe interesit, skontuar me normën e tregut të interesit në datën e raportimit.

Vlera e drejtë për mjetet monetare dhe ekuivalente me to, llogarive të arkëtueshme dhe pagueshme është afërsisht e barabartë me vlerën e tyre të mbartur për shkak të maturitetit të tyre afatshkurtër.

## Administrimi i riskut financiar

Shoqëria ekspozohet ndaj risqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumentave financiarë:

- risku i kredisë
- risku i likuiditetit
- risku i tregut.

Ky shënim paraqet informacion mbi ekspozimet e Shoqërisë ndaj secilit nga risqet e sipërpërmendur, objektivat, politikat dhe proceset që ajo përdor për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut. Shënime të tjera sasiore janë të përfshira në këto pasqyra financiare. Politikat e menaxhimit të riskut të Shoqërisë janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat përballet Shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve.

Politikat dhe sistemet e menaxhimit të riskut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe në aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, përmes trajnimeve dhe standardeve e procedurave të menaxhimit, synon të zhvillojë një ambient kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar në të cilin gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

Instrumentet financiare kryesore të Shoqërisë konsistojnë në vlerat në arkë dhe në banka, llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme, huamarrje dhe detyrime të tjera afatshkurtra.

### Rreziku kreditor

Ekziston një rrezik kredie në momentin që palët nuk arrijnë të përmbushin detyrimet e tyre lidhur me pagesat e llogarive të arkëtueshme.

Maksimumi i rrezikut të kredisë për instrumentet financiare jo-derivative është teorikisht i barabartë me vlerën e drejtë të të gjitha llogarive të arkëtueshme minus detyrimet kundrejt të njëjtit debitor kur kompensimi është i lejuar. Rreziku i kredisë i cili është identifikuar merret parasysh nëpërmjet zhvlerësimeve.

*Shoqëria e vlerëson cilësinë e llogarive të arkëtueshme që nuk janë me vonesë dhe as të zhvlerësuara por të kënaqshme.*

### Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor

Vlera e mbartur e aktiveve financiare përfaqëson ekspozimin maksimal ndaj riskut të kredisë. Ekspozimin maksimal ndaj riskut të kredisë në datën e raportimit ishte:



Ne leke

EMERTIMI	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Llogari te Arketueshme	3.309.192	4.509.192
Te Drejta ndaj Paleve te Lidhura	21.553.902	23.173.453
Paraja dhe Ekuivalentet e saj	280.943.346	237.439.017
<b>Shuma</b>	<b>305.806.440</b>	<b>265.121.662</b>

*Nuk ka një përqendrim të rëndësishëm të rrezikut të kredisë.*

#### Risku i likuiditetit

Shoqëria duhet të përmbushë nevojat për mjete monetare, kryesisht për kostot e shfrytëzimit që rrjedhin nga aktiviteti i saj. Ekziston rreziku që mjetet monetare mund të mos jenë të disponueshme për të shlyer detyrimet në kohën e duhur me një kosto të arsyeshme.

*Shoqëria monitoron likuiditetin e saj periodikisht në mënyrë që të administrojë detyrimet e saj kur nevojitet.*

#### **Ekspozimi ndaj riskut të likuiditetit**

Më poshtë janë paraqitur maturitetet kontraktuale të mbetura të aktiveve dhe detyrimeve financiare në 31 dhjetor 2021:

EMERTIMI	Ne Leke				
	Deri ne 1 Muaj	1-3 Muaj	3-12 Muaj	1-5 Vjet	TOTALI
Llogari te Aeketueshme				3.309.192	3.309.192
Te Drejta ndaj Paleve te Lidhura				21.553.902	21.553.902
Paraja dhe Ekuivalentet e saj	280.943.346				280.943.346
<b>Shuma</b>	<b>280.943.346</b>			<b>24.863.094</b>	<b>305.806.440</b>
Huamarrje	0	0	0	0	0
Detyrime ndaj palëve të lidhura				- 21.553.902	- 21.553.902
Llogari të pagueshme	-3.778.244				-3.778.244
Detyrime të tjera	0	0	0	0	0
<b>Shuma</b>	<b>-3.778.244</b>			<b>- 21.553.902</b>	<b>-25.332.146</b>
<b>Ekspozimi neto</b>	<b>277.165.102</b>			<b>3.309.192</b>	<b>280.474.294</b>
<b>Kumulative</b>	<b>277.165.102</b>				<b>280.474.294</b>

#### Risku i tregut

##### *Risku i normës së interesit*

Shoqëria përballet me ndikimin e flukseve të parasë nga norma e interesit lidhur me huatë që ka marrë dhe detyrimet.

*Manaxhimi i Shoqërisë nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje për instrumenta derivativë me qëllim mbrojtjen nga ky risk.*

### Ekspozimi ndaj riskut të normës interesit

Nuk ka ekspozim ndaj riskut të kredise.

### Risku i kurseve të këmbimit

Shoqëria kryen transaksione në Lekë, Euro, USD, e ne disa monedha të tjera.

Risku i monedhës kryesisht manaxhohet duke përdorur parimet e përputhjes së të drejtave dhe detyrimeve.

*Shoqëria nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje derivative për kontrata të ardhshme shkëmbimi më 31 dhjetor 2021.*

### Ekspozimi ndaj riskut të kursit të këmbimit

Kursi i këmbimit të Lek-ut në përfundim të periudhës raportuese ishte si më poshtë:

Ne Lek

EMERTIMI	Shenime	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
1 USD		106.54	100.84
1 EURO		120.76	123.70
E te tjera			

### Detyrime të kushtëzuara dhe angazhime

Nuk ka detyrime dhe angazhime të tjera në mbyllje të vitit 31 dhjetor 2021.

### Ngjarje pas datës së raportimit

Drejtimi i Shoqërise nuk është në dijeni të ndonjë ngjarjeje tjetër të ndodhur pas datës së raportimit, e cila mund të kërkonte rregullime apo shënime shtesë në pasqyrat financiare.

Drejtuesi i Shoqërise

Dilaver STAFA

